

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202200147/9

Tiranë ___/___/2023

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për trajtimin e rastit të minorenit në konflikt me ligjin me inicialet R.B., bazuar në interesin më të lartë të fëmijës

MINISTRISË TË DREJTËSISË

TIRANË

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP), në mbështetje të pikës 1, të nenit 60, të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, ka kryer në IEPV-në Kavajë hetimin administrativ "ex-officio", bazuar në situatën e rënduar psikologjike të minorenit me inicialet R.B., të ndaluar me vendimin nr.423, datë 26.7.2023 të Gjykatës të Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Gjatë kryerjes së hetimit administrativ, grupi i inspektimit vlerësoi dhe analizoi provat dhe faktet, si dhe intervistoi të miturin për t'u njohur me rrethanat e ngjarjes që kanë çuar në privimin e lirisë së tij.

I mituri me inicialet R.B., i datëlindjes 21.4.2007, ka lindur dhe është banues në Kaçanik, Kosovë. Bazuar në proces-verbalin për arrestimin e përkohshëm të minorenit R.B., AP-ja konstatoi se në orën 8.15, të datës 23 korrik 2023, ky i mituri është paraqitur për kontroll pranë Policisë Kufitare Porti Durrës, në hyrje të RSH-së, me një pasaportë kosovare me numër P02002459, në emër të shtetasit Petrit Bela, i datëlindjes 3.8.2002. Kjo pasaportë, nga verifikimi i kryer nga punonjësi i Policisë Kufitare Durrës, ka rezultuar që nuk i përkiste shtetasit R.B., i paraqitur pranë vendkalimit të kontrollit kufitar.

Në këto kushte, punonjësi i Policisë Kufitare Durrës ka kërkuar të dhënat e sakta nga i mituri me inicialet R.B., i cili është vetëidentifikuar. Nga regjistrimi

i të dhënave të deklaruara nga vetë shtetasi R.B., sistemi Tims ka dhënë Alert në sistemin ASF2. Bazuar në legjislacionin në fuqi për Policinë e Shtetit, punonjësi i Policisë Kufitare Durrës ka kërkuar informacion nga NCB Tiranë. Në orën 12.15, NCB Tiranë ka kthyer përgjigje se nga verifikimi në sistemin ASF të Interpolit për personin konkret është gjeneruar alert me status “wanted/i kërkuar”, me qëllim “Arrest”, i shpallur nga Interpol Paris, Francë. Gjykata Tribunale e Nancy/Francë, me vendimin e datës 13.6.2023, ka lëshuar urdhër-arresti ndërkombëtar për të miturin R.B., për kryerjen e veprës penale “Apologji publike për terrorizëm me anë të komunikimit online”.

Bazuar në nenin 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë (KPP), për shkak është shpallur person në kërkim ndërkombëtar, shtetasi kosovar R. B., është arrestuar në flagrancë.

Sipas, vendimi nr.423, datë 26.7.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, është vendosur “*miratimi i masës së përkohshme të sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga nenet 238 të KPP-së për qëllim ekstradimi, të kryer nga Policia Gjyqësore më datë 23.7.2023, ora 16.00, ndaj të miturit në konflikt me ligjin R. B., i biri i Sulltan dhe Zyrafete, i datëlindjes 21.4.2007, lindur dhe banues në Kaçanik, Kosovë, i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet franceze të Drejtësisë, pasi Gjykata Tribunale Nancy/Francë me vendim të datës 13.6.2023, ka lëshuar urdhër arrest ndërkombëtar për kryerjen e veprës penale “Apologji publike për terrorizëm me anë të komunikimit online”, parashikuar nga legjislacioni francez. Kjo masë arresti caktohet me afat 40 (dyzet) ditor”.*

Nga intervista e realizuar me të miturin me inicialet R.B., grupi i inspektimit u informua si vijon:

I mituri me inicialet R.B., ka mbaruar arsimin 9-vjeçar. Për kushte më të mira ekonomike ai ka emigruar në shtetin francez, me dokumenta të parregullta, nëpërmjet transportit rrugor. Për festën e Vitit të Ri të këtij viti ka arritur në Francë (për datat është konfuz dhe nuk i mban mend). Menjëherë, pas mbërritjes në shtetin francez, është regjistruar në kampin Foyer në Lion të Francës, ku ka qëndruar afërsisht rreth 2 javë. Duke qënë i mitur është transferuar në Nancy, ku autoritetet franceze i kishin dhënë një banesë dhe e kishin regjistruar në shkollë. Procesin mësimor e ka frekuentuar afërsisht për një periudhë kohore 2-3 javë. Sipas tij, një ditë në mjediset e shkollës kanë ardhur policë të veshur civilë dhe e kanë marrë në pyetje pa prezencën e psikologes, vetëm me përkthyes, lidhur me publikimin e videove në përmbajtje të së cilave pretendohet se kishte thirrje për terrorizëm (me armë të ndryshme, gjuhë e përdorur në vendet e Lindjes së Mesme) në platformën e komunikimit online (Tik-Tok), hapur në emrin e tij. Gjatë këtij procesi i është

sekuestruar dhe celulari personal. I mituri ka pretenduar se gjatë marrjes në pyetje trajtimi ka qenë mizor, duke mos u respektuar të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti. Mandej, ai ka qendruar për katër ditë në paraburgim. Gjithashtu, gjatë procesit të gjykimit me video-call, i mituri pretendon se është keqtrajtuar nga policët shoqërues (procesi është i regjistruar). Menjëherë, pas procesit të gjykimit është vendosur në CEF-FORBACH (Qendra Edukative e Mbyllur) në Forbach të Francës. Në këtë qendër duhet të qendronte për gjashtë muaj. Ai ka deklaruar se në qendër është trajtuar shumë mirë, ishte i vendosur në një dhomë më vete me tualet, dush dhe kishte edukatorin/kujdestarin e tij. Gjatë kësaj periudhe ka frekuentuar edhe klasat për edukim. I mituri me inicialet R.B., ka qendruar në këtë qendër vetëm 5 muaj. Ai deklaroi se është larguar nga qendra, pasi edukatori i tij me emrin Rashid i ka komunikuar që do ta fusnin në burg. Nga frika e burgimit ai është larguar nga qendra. Pas largimit nga qendra është nisur në drejtim të Nancy, Francë së bashku me dy shokë të tij me shtetësi franceze, të cilët i kishte njohur në këtë institucion. Me këta dy shokë ka qendruar vetëm dy ditë dhe më pas është larguar nga Nancy në drejtim të Almaz të Francës, që është në kufij me Zvicrën, për t'u takuar me vëllain e tij shtetasin Petrit Bela që jetonte në këtë shtet (Zvicër). Pasi është takuar me vëllain dhe është informuar se nënën e ka shumë të sëmurë (vetëm 40% e zemrës i punon) ai ka marrë pa leje pashaportën e vëllait për t'u kthyer në Kosovë dhe është kthyer.

Në kohën e hetimit administrativ nga AP-ja i mituri R.B., ndodhej në observim të IEPV-së Kavajë. Bazuar në rregulloren e IEPV-së, Kavajë observimi (qendrimi i mbyllur në dhomë me vete) është për një periudhë 10 ditore¹. Nga intervista e realizuar me grupin e inspektimit të AP-së, i mituri kërkoi që të mundësohej shkurtimi i ditëve që duhet të kryente në observim, pasi ndihet shumë i stresuar, pavarësisht, se ka patur mbështetjen dhe suportin e stafit të IEPV-së (realizimi i telefonatave, video-call me prindërit e tij zgjatja e orareve të ajrimit). Në këto kushte, grupi i inspektimit të AP-së realizoi një pyetësor (test psikologjik i standartizuar, instrument i metodologjisë për inspektimin e të miturve në konflikt me ligjin nga institucionet e pavaruara) me të miturin me inicialet R.B., ku evidentoi se niveli i stresit tek i mituri është i moderuar. Ndërkohë rezulton edhe se kuptueshmëria e tij në lidhje me situatën e tij nuk është shumë e qartë.

Bazuar në analizën e historikut të minorenit me inicialet R.B., duke marrë në konsideratë familjen (nëna e sëmurë), kontekstin social (familja që jeton në kushte të vështira social-ekonomike), si dhe eksperiencën e përjetuar nëpërmjet arrestimit, ndalimit, gjykimit dhe dënimit në një shtet tjetër, AP-ja ka

¹Rekomandim i AP-së adresuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Burgjeve për ndryshimin e rregullores së IEPV-së Kavajë duke e harmonizuar me dispozitat ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (202100450)

evidentuar se i mitur R.B., është i traumatizuar dhe në gjëndje të rënduar psikologjike.

Referuar Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardeve e normave të tjera ndërkombëtare, që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës, pavarësisht rolit që ka i mituri në një proces penal, qoftë aktiv (në konflikt me ligjin), qoftë pasiv (viktimë apo dëshmitar), atij duhet t'i garantohet në mënyrë të posaçme një proces ligjor i dedikuar, për të mos përkeqësuar traumën e përjetuar nga i mituri, duke nxitur dëshirën e tij për edukim dhe riintegrim në shoqëri. Aq më tepër që në rastin konkret ai pretendon se është keqtrajtuar dhe ekstradimi i parakohshëm mund të rendojë dhe më tepër situatën e tij psikologjike dhe mund të pengojë vazhdimësinë e procesit të riintegrit. Kjo, do të mundësonte dhe garantimin e të drejtave të tij nëpërmjet shterimit të të gjitha rrugëve të brendshme të gjykimit të tij.

Komentet Shpjeguese të Konventës Evropiane për Ekstradimin², e cila është ratifikuar nga Shqipëria dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1998, përcaktohet se: “Komenti 1. Në rastin e një të mituri që është nën moshën 18 vjeç në kohën e kërkesës për ekstradim (...), autoritetet kompetente të shtetit kërkues dhe të shtetit të kërkuar do të marrin parasysh interesat e të miturit dhe, kur mendojnë se ekstradimi ka të ngjarë të dëmtojë rehabilitimin e tij social, do të përpiqen të arrijnë një marrëveshje për masat më të përshtatshme (Res (75) 12)³. Po kështu në Komentin 2, pohohet se: “Ekstradimi nuk duhet të kërkohet kur vështirësitë që mund t'i shkaktohen personit të interesuar dhe familjes së tij janë haptazi në disproporcion me seriozitetin e veprës penale dhe kur dënimi që ka gjasa të jepet nuk do të kalojë periudhën minimale të paraburgimit, të përcaktuar në nenin 2, paragrafi 1 [të Konventës]⁴, ose nuk do të përfshijë heqjen e lirisë (Rec. R(80)7)”. Pra, sipas formulimit të nenit 2, paragrafi 1, ekstradimi kufizohet edhe më tej, e justifikuar kjo në rastet e veprave të lehta penale/ kundërvajtjeve.

Në procedurat e ekstradimit Ministria e Drejtësisë ka një rol të rëndësishëm, pasi krahas gjykatës ajo verifikon ekzistencën e kushteve për lejimin ose jo të ekstradimit (shih nenet 488 në vijim të KPP-së). Prandaj, Ministria duhet të marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse të sipërpërmendura (nivelin e stresit e shkaktuar, situatën e vështirë familjare, vështirësitë dhe shpenzimet e

² <https://rm.coe.int/168048bd42>

³ Faqe 16 e Komenteve Shpjeguese

⁴ Neni 2, paragrafi 1 i Konventës: “Ekstradimi do të jepet në lidhje me veprat penale të dënueshme sipas ligjeve të Palës kërkuese dhe të Palës së kërkuar me heqje të lirisë ose me urdhër paraburgimi për një periudhë maksimale prej të paktën një viti ose me një dënim më të rëndë”.

procedurës së ekstradimit, dënimin minimal prej një muaji që i mbetet të kryejë nëse ekstradohet, e kështu me rradhë⁵) për të vendosur në respekt të interesit më të lartë të fëmijës në rastin konkret.

Për gjithë sa parashtruam, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

REKOMANDOJMË:

- Vlerësimin e rastit duke pasur në vemëndje interesin më të lartë të të miturit me inicialet R.B., sipas Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe Komentit 2, të Konventës Evropiane për Ekstradim, për të siguruar aplikimin e saj në propocionalitet dhe për të mundësuar integrimin më të lehtë në familje dhe shoqëri.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 04. 02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi!

KOMISIONER

OLTA ALIAJ

⁵ Bazuar ne deklarinmet e minorenit me inicialet R.B.